



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-06/25
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	27.06.2025
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së gjashtë (06) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 27.06.2025, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit më pas konstatoi se në mbledhje marin pjesë të 12 anëtarët e Kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj. Leonora Shehu AD, znj. Vjollca Qestaj-DBF, z. Jetmir Jasiqi-DEZH, z. Zenun Shala DUKM, z. Fatos Shala-DSHMS, z. Demokrat Ganijaj-DSHPMSI.

Anëtarët prezent

- | | |
|---------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK |
| 4. Mursel Salihaj-Anëtar, LDK | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
| 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare, LVV |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizes Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale per vitin 2026, leximi i parë,
5. Informate lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në Komunën e Junikut,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të dëmeve të shkaktuara nga temperaturat e ulëta nën zero dhe reshjet e borës në pemishtet e “Pomona Farm” shpk dhe “Luna”shpk,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për përfshirjen e parcelave kadastrale në zonën urbane të Komunës së Junikut në kuadër të plotësim-ndryshimit të PZHK-së,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit dhe
9. Të ndryshme

Z. Shpejtim Gacaferi, me kërkesë të drejtorit të DSHPMSI pika e shtatë e rendit të ditës të tërhiqet nga shqyrtimi për mbledhjen e sotit, dhe më pas kemi një kërkesë nga Kryetari i Komunës që në pikën e shtatë të rendit të ditës të hynë kërkesa nga operatori ekonomik “Oda”, pra si pkë e 7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për përfshirjen e nja parcele në zonen urbane të komunës së Junikut në kuadër të plotësim-ndryshimit të PZHK-së. E qesë në votim rendin e ditës të paraparë për mbledhjen e sotit, kush është për, prezent jemi 10 antarët e Kuvendit, për 10 vota kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, tani e qesë në votim ndryshimin e pikës së shtatë të rendit të ditës, kush është për. Prezent jemi 10 antarët e Kuvendit, për 10 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës me ndryshim u miratua.

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,

Për këtë mbledhje mungojnë, z. Leonard Ljolluni-AAK, z. Zenel Maloku-AAK dhe znj. Festina Makoku-AAK.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028.

Arsyetimin dhe sqarimin e KAB për vitin 2026-2028 e bëri znj. Vjollca Qestaj-Drejtoreshë në DBF, e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë më pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve të Kuvendit KAB 2026-2028.

Gjatë sqarimit të kësaj pike në sallë të Kuvendit erdhi edhe anëtari Kuvendit z. Zenel Maloku, tani në sallë janë prezent 12 anëtarët e Kuvendit.

Z. Lulzim Gacaferi, përshendetje për të gjithë, ne kemi diskutuar shumë herë lidhur me kanalet e ujitjes në drejtim të fshatit Dobrosh tek shtëpia e Brahim Haxhisë, ajo pjesë ka mbetur pa kanale të ujitjes, në atë pjesë janë dhjetra hektarë tokë të banorëve të lagjes "Gacafer" por edhe të lagjeve të tjera, dhe unë e shoh të paarsyshme që këtë pjesë ta leni pa kanale të ujitjes.

Z. Ruzhdi Shehu, përshendetje për të gjithë, është e vërtetë që ajo pjesë ka mbetur pa kanale të ujitjes, ne e kemi diskutuar këtë çështje por në mungesë të buxhetit ka mbetur, kërkesa juaj është me vend dhe ne do t'i shikojmë mundesitë që përmes granteve të Ministrisë së Bujqësisë t'i ndërtojmë edhe ato kanale në atë pjesë.

Z. Dervish Bajraktari, përshendetje për të gjithë, sa i përket projekteve që i keni hijezuar, janë disa projekte që kanë qenë premtim që nga ardhja e juve në pushtet dhe tani jemi në përfundim të mandatit dhe as që keni filluar t'i bëni, një ndër to është ndërtimi i shehshit në Qendër të Junikut. Na keni thenë se e keni finalizuar projektin dhe ende nuk ka asnjë lëvizje në atë drejtim, projekti tjetër është rikostruimi i rrugës Shkëlzen Gacaferi faza e parë i keni ndarë 10,000 € dhe tani jemi në Korrik dhe asgjë në këtë drejtim, po ashtu kam kërkuar disa herë për një kanal të ujitjes në lagjen "Bajraktar" me gjatësi deri në 50m, dhe po bëhen një vit e gjysmë dhe ende asgjë nuk keni ndërmarrë, po ashtu edhe për rrugë fushore keni premtuar dhe po ju shkon mandati dhe asgjë nuk keni bërë, vetëm premtime boshe.

Z. Ruzhdi Shehu, rruga për lagjen Gacafer është në procedurë të prokurimit, poashtu edhe kanali në lagjen që e ceke janë të buxheturara dhe janë në procedurë të prokurimit, ndërsa sa i përket projektit të qëndres, ky projekt ka patur të fillojë, por për shkak të kontrates kolektive mjetet e parapara për këtë prokejt janë tërhequr nga përmbaruesi. Ky problem me kontratën kolektive nuk është problem vetëm i Komunës së Junikut por problem që e kanë të gjitha Komunitetet në Republikën e Kosovës.

Z. Zenel Maloku, përshendetje për të gjithë, fillimisht ju kërkoj falje për vonesë, në këtë Kuvend kam bërë kërkesë shumë herë që në fshatin Gjocaj të ndërtoni një kanal ta ujitjes në gjatësi 100m, kanal ky që do t'i shërbente fshatarëve të fshatit Jasiq, këtë kërkesë e kam bërë shumë herë, dhe nuk keni qenë në gjendje asnjehere të mereni me këtë çështje, dhe kjo për mua është një gabim që nuk falet.

Z. Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, e qesë në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore, kush është për, për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 3 vota, konstatoi se KAB 2026-2028 u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale për vitin 2026, leximi i parë

Sqarimin dhe arsyetimin e projekt-rregullores për taksa e bëri znj. Vjollca Qestaj-Drejtoreshë në DBF.

Z. Lulzim Gacaferi, në faqen 8, të telefonisë mobile është një shumë prej 500€, çka është paraparë kjo pagesë, poashtu në faqen 14, pika numër 9, për hapësira publike nuk keni vendosur çmim, poashtu të energjia keni vendosur një çmim kaq të ulët.

Z. Jetmir Jasiqi, përshendetje për të gjithë, çmimet janë vendosur në bazë të të hyrave që kanë ato kompani siç janë Vala dhe Ipko, dhe nesë Kuvendi mendon se çmimi është i ultë mund të merni vendim që këto çmime të rriten.

Z. Lulzim Gacaferi, sipas mendimit tim deri në 1,000 € do të jetë të mjaftushme, për deri sa këto kompani kanë rritur çmimet për qytetarët tanë edhe në t'i rrisim çmimet për këto kompani.

Z. Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, unë e qesë në votim projekt rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2026, kush është për? për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 3 vota, konstatoi se rregullorja për taksa u miratua.

4. Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në Komunën e Junikut,

Informatën e bëri z. Demokrat Ganiqaj- drejtor i DSHPMISI, i cili fillimisht i përshendeti të gjithë, dhe më pas informoj Kuvendin mbi gjendjen e shërbimeve publike në Komunën e Junikut.

Z. Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të dëmeve të shkaktuara nga temperaturat e ulëta nën zero dhe reshjet e borës në pëmishtet e "Pomona Farm" shpk dhe "Luna" shpk.

Arsyetimin dhe sqarimin e raportit e bëri z. Shkëlzen Shehu, kryesues i komisionit për dëme, i cili fillimisht i përshendeti të gjithë, dhe sqaroi para anëtarëve të Kuvendit raportin e dëmeve nga temperaturat e ulëta nën zero (0) dhe reshjet e borës në pëmishtat "Panoma farm" shpk dhe "Luna" shpk.

Z. Lulzim Gacaferi, në kohën kur janë bërë dëmet unë isha prezent dhe kam vizituar kompaninë "Luna shpk" dhe është mëse e vërtetë se ato dëme kanë ndodhur, andaj unë kërkoj nga kolegët e mi që ta përkrahim këtë raport.

Z. Zenel Maloku, unë jam që çdo kërkesë që vjen nga qytetarët dhe kompanitë Kuvendi t'i miratoj, por kisha dashtë që kur të bëhen komisionet të anëtarët e Komisionit të jenë adekuat.

Z. Mursel Salihaj, përshendetje për të gjithë, nëse dëmet janë dhe i keni konstatuar, nuk është më rëndësi a dëmtohet Komuna me pagesën e këtyre pagesave, këto dëme duhet të paguhen, nëse jo nga Ministria, duhet që një pjesë ta paguaj edhe Komuna.

Z. Dervish Bajraktari, sa i përket kësaj, unë fillimisht e përgëzoj këtë komision me kryesuesin z. Shkëlzen Shehu, dhe më atë sa kam njohuri në këtyre dy kompanive u janë bërë dëme shumë të mëdha, edhe unë jam që këto dy kompani t'i përkrahim dhe ta miratojmë këtë raport, por do ishte

e udhës që edhe ne si Komunë të kemi mundësi që të iu dalim në ndihmë këtyre kompanive, andaj unë i ftoj kolegët që ta përkrahin këtë raport.

Z. Xhemë Tofaj, përshendetje për të gjithë, unë deshta ta pyes kryesuesin e këtij komisioni z. Shkelzen Shehu, ku ka kompani tjera që kanë pësuar dëme, apo janë vetëm këto dy kompani? Sepse ne e dimë se në Komunën e Junikut operojnë disa kompani që merren me këto veprimtari-pemishte.

Z. Shkelzen Shehu, në bazë të kërkesave kemi bërë raport, kërkesë ka patur vetëm nga këto dy kompani, po të kishim kërkesë nga ndonjë kompani tjetër normal se do të kishim ndërmarrë diçka që ta përpilojmë raportin edhe për dëmet që iu janë shkaktuar atyre kompanive.

Z. Shpejtim Gacaferi, pyetje tjetër nuk ka, e qesë në votim raportin, kush është për, për 12 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se raporti i dëmeve të shkaktuar nga temperaturat e ulëta nën zero konstatoi se u miratua.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për përfshirjen e parcelave kadastrale në zonën urbane të Komunës së Junikut në kuadër të plotësim-ndryshimit të PZHK-së,

Z. Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka, e qesë në votim, kush është për, për 12 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se kjo kërkesë u miratua.

7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,

Z. Zenel maloku, pyetje për kryetarin e Komunës, a na lejohet të bëjmë ndërtime në fshatrat Jasiq dhe Gjocaj?

Z. Zenun Shala, meqenëse këto dy fshatra janë në zonën e Parkut Nacional dhe ky park është i ndarë në tri zona. Në zonën e tretë lejohet ndërtimi, ndërsa në zonën e dytë dhe të parë nuk lejohet ndërtimi, fshatrat "Jasiq" dhe "Gjocaj" janë në zonën e tretë ku lejohet ndërtimi, vetëm se duhet të pajisen me leje ndërtimi.

8. Të ndryshme.

Z. Dervish Bajraktari, çështja ka të bëjë me ndalesat (policë të shtrirë) që janë në rrugën për "Joos-Krasniqi", tek salloni i dasmave të "Toni", unë kisha propozuar që këso ndalesash të ketë më shumë, jo vetëm në atë rrugë por gjithandej ku është e nevojshme, dhe si kërkesë të veçantë e kam që në rrugët që të qojnë për në shkollë dhe veçanerisht në rrugën të shkolla, poashtu në rrugët e lagjes Bajraktar, këto ndalesa duhet të vendosen në këto rrugë për shkak se kamionët e kompanisë "Joos-Krasniqi" kalojnë në atë pjesë, dhe aty në atë rrugë kalojnë fëmijë dhe banorët e asaj lagjeje, andaj së paku dy pengesa janë të domosdoshme të vendosen në atë rrugë.

Znj. Rajmonda Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, edhe unë si z. Dervish Bajraktari, dua që të ngriti si çështje që në rrugën Bashkim Leku të vednosen pengesa (policë të shtrirë), sepse përpos automjeteve të lehta dhe të rënda siç janë kamionët tash po ka edhe motorra që ekstrem me shpejtësi të lartë lëvizin në atë pjesë, dhe në këtë mënyrë paraqesin rrezik për banorët e asaj ane.

Z. Zenel Maloku, çështja që po dua ta ngriti ka të bëjë rreth këtij Kuvendit për drejtorët e komunës për zyrtarë të kësaj komune, sepse mendoj se është bërë një punë e padrejtë e qoroditur, Neve në Kuvend na kanë sjellur votat e qytetarëve, dhe ne i përfaqësojmë qytetarët e kësaj komune, andaj nëse nonjë punë bëhet e qoroditur ne nuk kemi mundësi pa e përmend, këtu ka ndodhur që zyrtarët komunal kanë ngritur padi në gjykatë, sa që kanë kërkuar nga njerzit me nga 1,0000€ gjoja për lëndime, kjo është për drejtorin e shërbimeve publike që ka bërë padi në gjykatë për lëndim shpirtëror që ka rrafshuar varret në fshatin Gjocaj, dhë për këto lëndime shpirtnore ka kërkuar nga 2,0000€, po të kishte lëndime shpirtnore nuk do i kishte prishur varret në Gjocaj, por kjo ka qenë sport për të.

Z. Shpejtim Gacaferi, unë po ndërhy këtu sepse kjo çështje është toleruar shumë në këtë Kuvend, është e sata herë që po diskutohet si temë dhe tashmë është e tëpruara, nëse konflikti ka lind në këtë Kuvend dhe është bartur në gjykatë me vjen keq, por edhe nëse konflikti ka lindur jashtë Kuvendit dhe ka padi për këtë, ne nuk kemi çka të bëjmë, vetëm që t'ia lëmë në dorë drejtesisë.

Z. Lulzim Gacaferi, nëse padija ka dalë nga ky Kuvend duhet që z. Zenel Maloku t'i lejohet ta diskutoj këtë çështje këtu në Kuvend.

Z. Ruzhdi Shehu, ne duhet të jemi kujdesshëm me deklaratimet publike dhe në fjalimet që bëhen në foltoren e Kuvendit, çdo shpifje që bëhet qytetari ka të drejtë ta apeloj në gjykatë dhe gjykata e ndanë drejtësinë.

Z. Shpejtim Gacaferi, çështje tjetër nuk ka dhe e shpalli të mbyllur mbledhjen e Qershorit, 2025.

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

